



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr. 60/01- 5907/25
Kaçanik, 20.03.2025

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **III (tretë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 20 mars 2025 (e Enjte). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 13:00. Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Betim Shala-LDK, Arben Thaqi- OJQ, ndërkaq nga zyrtarët: Hajrush Dullovi.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse Maviqe Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka: Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e III-të (tretë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2025, data 20 mars, me këtë :

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
2. Gjendja e Arsimit në komunën e Kaçanikut;
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete,

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka: A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?

Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverbali ?
Procesverbali i mbledhjes se II-të (dytë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2025, u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komiteti për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes se II-të (dytë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2025,
të datës 25.02.2025 / Lënda: 01Nr. 60/01-4494/25.

2. Gjendja e Arsimit në komunën e Kaçanikut;

z.Ekrem Livoreka: Lidhur me këtë pikë e hapi diskutimin:

z.Hajrush Dullovi: Drejtorja e Arsimit sjell në Kuvend tri informata gjatë vitit shkollor:

Informatë për fillimin e vitit shkollor, e cila prezantohet në muajin shtator, ku jepen të dhënat karakteristike për fillimin e vitit të ri shkollor.

Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë.

Informatë për përfundimin e vitit shkollor.

Arsimi në Komunën tonë organizohet në katër nivele: 0, 1, 2 dhe 3 (Parafillor, Fillor, i Mesëm i Ulët dhe i Mesëm i Lartë).

Viti i ri shkollor 2024/2025 ka filluar më 2 shtator 2024, sipas kalendarit shkollor të hartuar nga MASHTI dhe ka përfunduar më 24 dhjetor 2024.

Mësimi ka filluar në të gjitha institucionet arsimore: 21 institucione shkollore të niveleve AF (Arsimi Fillor) dhe AMU (Arsimi i Mesëm i Ulët), prej tyre 16 shkolla të plota

(klasat 1-9) dhe 4 shkolla të tjera ku mësimi zhvillohet për klasat 1-5. Ndërkaq, në një shkollë mësimi zhvillohet vetëm për klasat 1-4. Po ashtu, mësimi është zhvilluar edhe në 2 institucione të Arsimit të Mesëm të Lartë dhe në një çerdhe për fëmijë. Edhe këtë vit shkollor kanë filluar me kohë përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2024/2025, në

përputhje me nevojat e identifikuar dhe kërkesat për një fillim sa më të mbarë të procesit edukativo-arsimor në komunën tonë. Fillimisht është bërë planifikimi i regjistrimit të fëmijëve parafillorë dhe atyre në klasat e para.

Bazuar në raportin e këtij fillimi të vitit shkollor, sivjet janë regjistruar 352 fëmijë parafillorë – prej tyre 321 në shkollat fillore dhe 31 të tjerë në QEAP “Agimi” në Kaçanik. Në këtë qendër parashkollore, nga mosha 9 muajshe deri në 5 vjeç, janë të

sistemuar gjithsej 121 fëmijë.

Po ashtu, sipas të dhënave të shkollave fillore, sivjet në klasat e para janë regjistruar gjithsej 372 nxënës. Është bërë edhe planifikimi i regjistrimit të nxënësve në klasat e dhjeta në dy shkollat e mesme: në Gjimnazin “Skënderbeu” dhe në IAAP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”.

Në Gjimnazin “Skënderbeu”, në klasat e dhjeta janë regjistruar 140 nxënës, ndërsa ishin planifikuar të regjistroheshen 224 nxënës të ndarë në 7 paralele:

Drejtimi Shkencat Natyrore: 4 paralele me 84 nxënës të regjistruar

Drejtimi Shkencat Shoqërore-Gjuhësore: 3 paralele me 55 nxënës

Ndërkaq, në IAAP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” janë regjistruar gjithsej 142 nxënës në 9 paralele, ndërsa kanë qenë të planifikuar të regjistroheshen gjithsej 272 nxënës të ndarë në tri drejtime.

Numri i nxënësve të regjistruar sipas drejtimeve dhe profileve në klasat e dhjeta:

1. Elektroteknikë, Makineri, Prodhim dhe Ndërtimtari

- Instalues elektrikë – 1 paralele me 19 nxënës

- Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit – 2 paralele me nga 15 nxënës (gjithsej 30 nxënës)

- Automekanik – 1 paralele me 14 nxënës

- Metalpunues – 1 paralele me 14 nxënës

- Trafik rrugor – 1 paralele me 17 nxënës

2. Ekonomi, Administrim dhe Juridik

- Nëpunës i kontabilitetit dhe tatimeve – 1 paralele me 18 nxënës
- Nëpunës i administratës dhe shërbimeve të zyrës – 1 paralele me 15 nxënës

3. Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit

- Informatikë – 1 paralele me 16 nxënës

Në Komunën e Kaçanikut funksionojnë 11 shkolla amë (fillore dhe të mesme të ulëta) dhe 10 paralele të ndara fizike:

SHFMU "Emin Duraku" në Kaçanik, me paralelet e ndara në Dushkajë dhe Raunjëvë

SHFMU "Idriz Seferi" në Bob, me paralelet e ndara në Kovaçec dhe Gajre

SHFMU "Jusuf Gërvalla" në Biçec, me paralelen e ndarë në Nikaj

SHFMU "Kadri Zeka" në Dubravë, me paralelet e ndara në Vatë dhe Provol

SHFMU "Ali Asllani" në Doganaj

SHFMU "Nazmi Osmani" në Elezaj, me paralelen e ndarë në Bajnicë

SHFMU "Qamil Ilazi", me paralelen e ndarë në Fushë të Pajtim

SHFMU "7 Shtatori" në Begracë

SHFMU "Agim Bajrami" në Stagovë

SHFMU "Gafurr Luma" në Gllaboçicë

SHFMU "Dituria" në Ivajë, me paralelen e ndarë në Strazhë

znj. Arta Avdiu: Kjo informatë na është sjellë muajin e kaluar në Kuvend. Si shqetësim kemi ngritur çështjen e rënies së vazhdueshme të numrit të nxënësve në regjistrim. Dëshiroj të di më shumë lidhur me këtë çështje, sepse, siç është cekur, rënia e numrit të nxënësve paraqet rrezik real për mbylljen e shkollave, dhe rrjedhimisht, mësimdhënësit në ato shkolla mund të mbesin pa punë.

Cila shkollë është më e rrezikuar aktualisht?

Çfarë masa janë paraparë për mësimdhënësit në rast të mbylljes së ndonjë shkolle?

Një tjetër shqetësim që e kemi ngritur vazhdimisht është rritja e mungesave, si nga nxënësit, ashtu edhe nga mësimdhënësit. Dëshiroj të di: Çfarë masa janë ndërmarrë për përmirësimin e kësaj gjendjeje?

Gjithashtu, si e vlerësoni përfshirjen e prindërve dhe të komunitetit në procesin arsimor në komunën tonë, dhe sa i qasshëm është raporti mes prindit dhe mësimdhënësit?

z.Hajrush Dullovi: Është e vërtetë që numri i nxënësve është në rënie të vazhdueshme çdo vit.

Sa i përket mësimdhënësve, është ndjekur një politikë për moszëvendësimin e menjëhershëm të atyre që pensionohen, përveç rasteve të domosdoshme, duke u munduar që mësimdhënësit e shkollave që mbyllen të sistemohen në shkolla të tjera. Deri më tani janë mbyllur disa shkolla, si: Sllatina, Semaja, Llanishta, Gjurgjudelli dhe Kotlina, por është ruajtur një farë stabiliteti.

Mungesat janë shqetësuese, sidomos vitet e fundit. Megjithatë më herët situata ishte më e kontrolluar, tani ka më shumë raste.

Zbatohet rregullorja e brendshme, e cila përfshin masa ndëshkuese, por është vërejtur që këto masa nuk kanë pasur ndikimin e pritur.

Është bërë përpjekje për transferimin e nxënësve në shkolla të tjera, duke u siguruar që t'u ofrohet transporti i nevojshëm.

Kemi kërkuar bashkëpunim më të ngushtë për ta zvogëluar numrin e mungesave, sepse mungesat ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e mësimi. Humbja e orëve është e pashmangshme kur ka mungesa të mëdha, qoftë nga nxënësit, qoftë nga mësimmhënësit. Bashkëpunimi prind-mësimdhënës është vlerësuar si pozitiv, por efektet nuk janë në nivelin që dëshirohet.

z.Arben Thaçi: Sa i përket digjitalizimit, më duhet të them që situata në shkollën ku punoj dhe në shumë shkolla të tjera nuk është aspak e kënaqshme. Shumë shpesh flitet për digjitalizim, por në realitet mungojnë pajisjet elementare. Njëra nga pjesët kyçe të procesit të licencimit të mësimmhënësve është përdorimi i mjeteve digjitale gjatë orës mësimore që do të thotë se vlerësohet edhe aftësia e arsimtarit për të përdorur mjete moderne. Por, si mund të vlerësohet drejt një arsimtar, nëse vetë shkolla nuk i ofron mundësinë ta shfaqë atë aftësi? Në mungesë të një table digjitale, mësimmhënësi penalizohet, merr zero pikë në atë aspekt kjo është brengosëse dhe padrejtësi që prek drejtpërdrejt cilësinë e mësimmhënies.

Një tabelë digjitale sot nuk është më luks, nuk është e kushtueshme, por domosdoshmëri. E shohim që ka investime të mëdha, mirëpo mendoj që drejtoria e Arsimit duhet të ketë prioritete të qarta dhe investimet të bëhen mbi bazën e këtyre prioriteteve. Për shembull, në shkollën tonë do të ishte shumë më efektive që tabelat digjitale të vendosen në ndonjë klasë që përdoret rregullisht, sesa të vendosen në kabinete që qëndrojnë të mbyllura shumicën e kohës.

Gjithashtu, sa jeni në dijeni për gjendjen higjienike nëpër shkolla? Është katastrofale. Keni përmendur edhe terrenet sportive por a i keni menduar se me rritjen e hapësirës shkollore, rritet edhe nevoja për personel teknik shtesë? Deri tani, nuk është shtuar asnjë punëtor teknik për të përballuar këtë ngarkesë.

Sa i përket garave të diturisë a keni informata të sakta se sa nxënës kanë marrë pjesë? Si janë organizuar?

Çfarë cilësie kanë pasur këto gara dhe çfarë impakti kanë lënë te nxënësit dhe te shkollat? Gara duhet të jenë një formë motivimi dhe zhvillimi për të gjithë, por ka pasur raste kur jo të gjithë nxënësit janë përfshirë. Ka pasur madje paralelja që janë injoruar plotësisht nga ndonjë mësimmhënës, i cili ka zgjedhur vetëm nxënës nga një klasë apo grup të caktuar. Për mua, kjo është formë diskriminimi që nuk duhet të ndodhë në një sistem që synon barazi dhe cilësi.

z.Ekrem Livoreka: Jemi në pjesën e kontratës kolektive që i prek drejtpërdrejt arsimtarët, dhe është një shumë e konsiderueshme që komuna ka pasur obligim ta realizojë, por fatkeqësisht kjo ende po zvarritet. Pavarësisht marrëveshjes së arritur me SBASHK-un, nuk është arritur zbatimi i saj në praktikë. Do të ishte me rëndësi të sqarohej se cilët kanë përfituar konkretisht nga kjo marrëveshje, sepse duket se jo të gjithë janë trajtuar njësoj. Dikush po i merr të drejtat, ndërsa dikush tjetër mbetet jashtë, dhe kjo ka shkaktuar pakënaqësi të arsyeshme tek shumë arsimtarë.

z. Hajrush Dullovi: E di që një kontingjent i tabelave digjitale është dashur të vijë dhe pritët të arrijë shumë shpejt. Më është thënë se shkollat profesionale do të jenë të furnizuara mirë, pasi procedurat janë kryer. Megjithatë, prioritet më i madh i është dhënë gjimnazit. Sidoqoftë, mbetet me rëndësi që të gjitha shkollat të trajtohen me barazi kur bëhet fjalë për pajisje bazike që ndikojnë direkt në cilësinë e mësimmhënies. Është përmendur që gjatë vizitave nëpër shkolla higjiena ka qenë në nivel të kënaqshëm. Megjithatë, nga përvoja në terren, ka raste kur gjendja është larg asaj që mund të quhet e

pranueshme. Me rritjen e hapësirave dhe të numrit të nxënësve, kërkohet patjetër edhe shtim i stafit teknik për mirëmbajtje, që për momentin mungon në disa shkolla. Garat e diturisë janë organizuar pothuajse çdo vit për 7 lëndë kryesore. Për këtë vit është menduar që të ndryshohet mënyra e organizimit, duke kërkuar një agjenci të licencuar që të organizojë garat në mënyrë më profesionale, për shkak se aktualisht ka vështirësi në funksionim sidomos për hartimin dhe kontrollimin e testeve, që kërkon pagesë. Nga ana tjetër, ka pasur pakënaqësi për mungesën e gjithëpërfshirjes. Në disa raste është raportuar se një paralele është përfshirë në gara, ndërsa të tjerat jo dhe kjo për shkak të përzgjedhjeve personale nga ndonjë mësues. Kjo formë diskriminimi dëmton barazinë dhe motivimin e nxënësve. Sa i përket zbatimit të marrëveshjeve të kontratave kolektive, ato që janë pjesë e marrëveshjes do të përfundojnë në muajin korrik, sipas planifikimeve aktuale. Shpresohet që ky afat të respektohet dhe çdo obligim të përmbushet me përpikëri.

z. Arben Thaçi: Ka nisur një projekt shumë i mirë për sportin në shkolla dhe është e rëndësishme që secila shkollë të aplikojë, nëse i plotëson kushtet. Afati është i përcaktuar dhe dokumentacioni duhet të përgatitet sipas kriterëve të kërkuara. Megjithatë, nuk duhet të aplikojnë shkollat që nuk i përmbushin kriteret teknike, si për shembull mungesa e dimensioneve të duhura për sallat sportive. Për momentin, vetëm salla e sporteve i plotëson kushtet për zhvillimin e lojës së hendbollit.

3. Të ndryshme:

z. Ekrem Livoreka: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 14:15.

Procesmbajtës
Mavije Murseli



Kryesues i Komitetit
Ekrem Livoreka

